



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 5 tetor 2017  
Nr. ref.:RK 1131/17

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI28/17

Parashtrues

**Azem Gashi dhe Arbenita Gashi**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së  
Aktgjyimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 262/2016,  
të 3 nëntorit 2016**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

#### Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Azem Gashi dhe Arbenita Gashi, me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës), të cilët përfaqësohen nga Zaim Istrefi, avokat nga Prishtina.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 262/2016, të 3 nëntorit 2016, i cili u është dorëzuar parashtruesve të kërkesës më 16 nëntor 2016.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 262/2016, të 3 nëntorit 2016, me të cilin parashtruesit e kërkesës pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) si dhe nenin 6 (E Drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 7 mars 2017, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 7 prill 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Bekim Sejdiu dhe Gresa Caka-Nimani.
7. Më 13 prill 2017, Gjykata njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme të Kosovës.
8. Më 17 korrik 2017, përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës dorëzoi në Gjykatë Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, P. nr. 2850/08, të 10 shkurtit 2012.
9. Më 6 shtator 2017, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

10. Më 7 gusht 2008, parashtruesit e kërkesës pësuan lëndime të rënda trupore në një aksident komunikacioni të shkaktuar nga shfrytëzuesi i Kompanisë së Sigurimeve “Sigal Uniqa Group Austria” në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Kompania “Sigal”).



11. Më 10 shkurt 2012, Gjykata Komunale në Prishtinë [Aktgjykimi P. nr. 2950/08], e shpalli fajtor G.B, shfrytëzuesin e sigurimit të veturës së Kompanisë “Sigal”, për vepër penale “*Rrezikim i trafikut publik*” nga neni 297 par. 5 lidhur me par.3 dhe 1 të Kodit të Procedurës Penale.
12. Më 15 tetor 2012, parashtruesit e kërkesës parashtruan padi për shpërblim të dëmit jomaterial në Gjykatën Themelore kundër Kompanisë “Sigal”, duke precizuar kompensimin (lartësinë e shumës) për të gjitha format e dëmit që u janë shkaktuar nga aksidenti.
13. Në një datë të pacaktuar, Kompania “Sigal” paraqiti përgjigje në padi, duke e kontestuar shumën e shpërblimit të dëmit jomaterial, si dhe duke i ofruar parashtruesve të kërkesës ofertë për pajtim gjyqësor. Parashtruesit e kërkesës nuk e pranuan ofertën për pajtim gjyqësor.
14. Më 14 dhjetor 2012, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktgjykimi C. nr. 1793/08), aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë, duke e detyruar Kompaninë “Sigal” që t’ia kompensojë dëmin jomaterial parashtruesve të kërkesës, të shkaktuar nga shfrytëzuesi i sigurimit të Kompanisë “Sigal”.
15. Më 25 prill 2013, Kompania “Sigal”, paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 1793/08, të 14 dhjetorit 2012, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
16. Më 10 mars 2016, Gjykata e Apelit e Kosovës (Aktgjykimi CA. nr. 3287/13), aprovoi ankesën, ndryshoi pjesërisht Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 1793/08, të 14 dhjetorit 2012, duke e detyruar Kompaninë “Sigal”, që në emër të dëmit, të pësuar si rezultat i aksidentit në trafik, parashtruesve t’ua paguajë shumën më të vogël se ajo e përcaktuar nga Gjykata Komunale. Në aktgjykim arsyetohet se:
 

*“[...] me rastin e vendimmarjes gabimisht e ka zbatuar të drejtën materiale kur ka caktuar shumat për kompensimin e dëmit jomaterial si në dispozitivin e aktgjykimit ankimor, pasi që ato nuk janë në përputhje me kriteret, si dhe standardin jetësor në Kosovë, pra tejkalojnë shumat që do të ishin adekuate për satisfaksion dhe në përputhje me qëllimin e dispozitës ligjore të nenit 200 të LMD së vitit 1978, si dhe me praktikën gjyqësore të krijuar gjatë trajtimit të rasteve të tilla nga Gjykata në Kosovë, përfshirë edhe qëndrimet e Gjykatës Supreme të Kosovës [...].”*
17. Më 6 maj 2016, parashtruesit e kërkesës kanë paraqitur kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, CA. nr. 3287/13, të 10 marsit 2016, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
18. Në një datë të pacaktuar, Kompania “Sigal” paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, për shkak të *“tejkallimit të kërkesëpadisë, me propozim që, aktgjykimi i atakuar të ndryshohet dhe kërkesëpadija e paditësve të aprovohet pjesërisht.”*

19. Më 3 nëntor 2016, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktgjykimi Rev. nr. 262/2016), refuzoi si të pathemeltë revizionin e parashtruesve të kërkesës dhe të Kompanisë “Sigal”, duke arsyetuar se gjykata e shkallës së dytë në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat e të drejtës materiale dhe duke e mbështetur plotësisht Aktgjykimin CA. nr. 3287/13, të 10 marsit 2016, të Gjykatës së Apelit.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

20. Parashtruesit e kërkesës pohojnë se me vendimet e gjykatave të rregullta u janë shkelur të drejtat e tyre kushtetuese, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës si dhe nenin 6 (E Drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
21. Parashtruesit e kërkesës, pretendojnë se *“Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme me vendimet e cekura më lart, nuk kanë dhënë arsyetim bindës se pse e kanë ndryshuar vendimin e Gjykatës Komunale, pasi që edhe me nenin 200 të LMD-së është përcaktuar qëllimi i kompenzimit, e në rastin konkret parashtruesve të kërkesës iu janë shkullur të mirat esenciale, andaj vendimi nga Gjykata Komunale do t’ju shërbente si shpërblim i drejtë [...]”*
22. Parashtruesit më tej pretendojnë *“Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme me aktgjykimet e tyre nuk iu kanë referuar ndonjë arsye faktike ose ligjore në lidhje me atë se si dhe pse e ka ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës së shkallës së parë.”*
23. Parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që të shfuqizojë Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 3287/13, të 10 marsit 2016 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 262/2016, të 3 nëntorit 2016 si dhe të mbetet në fuqi Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 1783/08, të 14 dhjetorit 2012.

### **Pranueshmëria e kërkesës**

24. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara më tej me Ligj dhe të specifikuara me Rregullore të punës.
25. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

*“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publik.*

*(...)*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

26. Megjithatë, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:



*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”*

27. Në këtë drejtim, Gjykata më tej i referohet rregullit 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

*(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse*

*(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*

*(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*

*[...]*

*(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.*

28. Në këtë rast, Gjykata vlerëson se parashtruesit e kërkesës janë palë të autorizuar, i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion dhe e kanë dorëzuar kërkesën brenda afatit të paraparë kohor. Megjithatë, Gjykata, më tej, duhet të vlerësojë nëse janë përmbushur kërkesat e përcaktuara në nenin 48 të Ligjit dhe të parapara në rregullin 36 të Rregullores së punës.

29. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 3287/13, të 10 marsit 2016 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 262/2016, të 3 nëntorit 2016, u ishin shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe për mbrojtje gjyqësore, për shkak të mosarsyetimit të vendimeve, si rezultat i uljes së vlerës për shpërblim të dëmit jomaterial, si pasojë e lëndimeve të marra nga aksidenti në trafik.

30. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 31 të Kushtetutës, i cili përcakton:

*“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*

*2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.”*

31. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh nenin 6.1 të KEDNJ-së, me të cilin përcaktohet:

*“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda afatit të arsyeshëm nga një gjykatë.”*

32. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme nuk i kanë arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme vendimet e tyre, në pjesët në të cilat është prishur Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 1793/08, i 14 dhjetorit 2012 dhe se nuk e kanë vlerësuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike.
33. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës pretenduan në Gjykatën Supreme shkelje të së drejtës materiale. Gjykata konsideron se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme adresoi dhe vendosi për bazat e ankesës së lartpërmendur. Për këto arsye, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme është tani vendim përfundimtar për këtë çështje kontestuese.
34. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. nr. 262/2016, të 3 nëntorit 2016, me të cilin ishte konkluduar se Gjykata e Apelit me Aktgjykimin Ac. nr. 3287/2013, të 10 marsit 2016, ka zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat e të drejtës materiale.
35. Gjykata Supreme në Aktgjykimin Rev. nr. 262/2016, të 3 nëntorit 2016 vlerësoi se *"gjykata e shkallës së dytë ka zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat e të drejtës materiale, kur ka miratuar pjesërisht ankesën e së paditurës dhe ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë [...] aktgjykimi i goditur nuk përmban shkelje të karakterit thelbësorë të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat kjo Gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare [...] Për sa i përket shumave të gjykuara nga Gjykata e shkallës së dytë (pjesa e ndryshuar) përkitazi me llojet e sipërpërmendura të dëmit jomaterial, drejt është aplikuar dispozita e nenit 200 të LMD-së lidhur me nenin 323 të LPK-së, duke patur parasysh konstatimet dhe mendimet e ekspertëve përkatës mjekësor[...]. Vlerësimi i shpërblimit për dëmin jomaterial (si një satisfacion që nuk ka qëllim lukrativ-fitimprurës), përfaqëson zbatimin e së drejtës materiale."*
36. Gjykata konsideron se Gjykata Supreme jo vetëm që vërtetoi arsyet e dhëna në Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 3287/13, të 10 marsit 2016, por edhe adresoi çështjet thelbësore që lidhen me pretendimin për *"shkelje të së drejtës materiale."*
37. Lidhur me këtë, Gjykata vlerëson se Gjykata Supreme i ka vlerësuar provat në tërësi, duke i analizuar faktet dhe duke konsideruar se *"gjatë caktimit të lartësisë së shpërblimit për format e caktuara të dëmit jomaterial, dhe të frikës si lloj i mëvetësishëm i dëmit jomaterial, gjykata sipas nenit 200 të LMD-së, duhet të kujdeset për rëndësinë e së mirës së dëmtuar dhe qëllimit të cilit i shërben ai shpërblim, por edhe për çështjen që të mos favorizojnë synimet të cilat nuk janë në përputhje me natyrën e shpërblimit të tillë të dëmit jomaterial [...] shumat e caktuara nga gjykata e shkallës së dytë përkitazi me llojet e sipërcekura të dëmit jomaterial, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, janë reale në përputhje me kriteret e parapara ligjore dhe në harmoni me praktikën gjyqësore."*
38. Lidhur me pretendimin e parashtruesve se Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme nuk kanë arsyetuar mjaftueshëm vendimet e tyre, Gjykata përsërit se, në përputhje me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, e drejta për një vendim të arsyetuar përfshin një kompleks të detyrimeve të vendimeve të



Gjykatës, përkatësisht, që të ofrojnë arsyet mbi të cilat është bazuar vendimi, t'ua demonstrojnë palëve që ato janë dëgjuar, t'ua sigurojnë mundësinë për t'u ankuar kundër vendimit dhe të sigurojnë qartësi të mjaftueshme të shkaqeve mbi të cilat është nxjerrë vendimi.

39. Edhe pse gjykata e rregullt ka liri të caktuar të vlerësimit në zgjedhjen e argumenteve dhe pranimin e provave, neni 6 (1) nuk kërkon një përgjigje të detajuar për çdo argument që i ofrohet gjykatës gjatë mbajtjes së procedurës (Shih, *Suominen kundër Finlandës*, nr. 37801, GEDNJ, Aktgjykimi i 24 korrikut 2003, para. 36, *Van de Hurk kundër Holandës*, Nr. 16034/90, GJEDNJ, Aktgjykim i 19 prillit 1994, para. 61; *Jahnke dhe Lenoble kundër Francës* (déc.); *Perez kundër Francës* [DHM] Nr. 47287/99, GJEDNJ, Aktgjykim i 12 prillit 2004, para 81; *Ruiz Torija kundër Spanjës*, Nr. 18390/91, GJEDNJ, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, para 29; *Hiro Balani kundër Spanjës*, kërkesa nr. 18064/91. GJEDNJ, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, para 27).
40. Gjykata konsideron se Gjykata Supreme adresoi të gjitha shkaqet e ankesës të ngritura në kërkesën për revizion të parashtruesve të kërkesës. Prandaj, parashtruesit e kërkesës kanë pasur qasje të mjaftueshme në gjykatat e rregullta dhe mundësi të mjaftueshme për të paraqitur prova dhe argumente në lidhje me çështjen e tyre të kontestuar.
41. Në të vërtetë, është detyrë e gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rasti i GJEDNJ-së, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, 21 janar 1999, para. 28).
42. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës i paraqitën në Gjykatën Kushtetuese në thelb të njëjtat baza të ankesës që ata i kanë paraqitur në shkallën e fundit.
43. Gjykata Kushtetuese rikujton se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve dhe se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është brenda juridiksionit të gjykatave të rregullta. Roli i Gjykatës Kushtetuese është që të sigurojë respektimin e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me instrumente të tjera ligjore, dhe për këtë arsye nuk mund të veprojë si gjykatë e “shkallës së katërt” (Shih: rastet e GJEDNJ-së, *Akdivar kundër Turqisë*, Kërkesa nr. 21893/93, 16 shtator 1996, paragrafi 65. Rasti i Gjykatës Kushtetuese KI86/11, parashtruesi i kërkesës: *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmërinë, i 5 prillit 2012).
44. Për më tepër, parashtruesit nuk kanë arritur të tregojnë dhe të dëshmojnë në baza kushtetuese se procedurat në gjykatat e rregullta, duke përfshirë edhe Gjykatën Supreme, ishin të padrejta apo arbitrare apo që të drejtat dhe liritë e tyre janë shkelur. Faktet e rastiit nuk tregojnë se gjykatat e rregullta kanë vepruar në kundërshtim me masat mbrojtëse procedurale të përcaktuara me Kushtetutë.
45. Nga sa u tha më sipër, Gjykata konstaton se në përgjithësi është respektuar e drejta e parashtruesve të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm gjatë procedurës dhe, në mënyrë më specifike, ata kishin qasje të lirë në gjykata, u ishin dhënë aktgjykime të arsyetuara në shkallë të ndryshme të

procedurës. Gjykata më tej konstaton se, në pajtim me këtë, mbrojtja gjyqësore ishte e garantuar.

46. Prandaj, pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe mbrojtje gjyqësore janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese.
47. Në bazë të asaj që u tha më lart, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesve nuk i përmbush kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
48. Prandaj, kërkesa, është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës, më 6 shtator 2017, njëzëri

### **VENDOS**

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtarja raportuese**



Selvete Gërxhaliu-Krasniqi



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**



Arta Rama-Hajrizi